

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 7 KORRIK 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Për të qenë realistë dhe me këmbë në tokë, meqenëse shumë nga pjesëtarët e qeverisë duartrokitën për suksese që nuk ekzistojnë, për besimin e madh që kanë partnerët ndërkombëtarë në luftën kundër korrupsionit dhe për shkak të saj do të ndodhë edhe hapja e negociatave, me të drejtë kolegja Zhupa tha se këto negociata janë hapur që në vitin 2018. Në rast se nuk janë hapur akoma, besoj se Kryeministri duhet të ketë minimumin e sqimës që të anulojë medaljet që u ka dhënë ambasadorëve, të cilët i ka dekoruar për suksesin e arritur që në vitin 2018. Pasi u kaluan dallgët e oqeanit u arrit edhe integrimi. Megjithatë, këto janë rutinë e këtij mashtrimi bajat që ne jemi mësuar ta dëgjojmë përherë.

Duke ruajtur marrëveshjen që kemi bërë së bashku, do t'u referohem vetëm fakteve të pakundërshtueshme, që nuk vijnë nga opozita. Meqë doni vlerësimin e institucioneve ndërkombëtare, e freskët fare është rezoluta e Parlamentit Europian, jo e këtij parlamenti, e datës 19 maj, miratuar me 514 vota, ku duam të shkojmë dhe të hapim negociatat, e cila thekson detyrimin e autoriteteve shqiptare për të vazhduar eliminimin e korrupsionit dhe aktiviteteve kriminale nga të gjitha fushat e jetës publike, duke përfshirë procedurat e prokurimit publik. Po në këtë rezolutë thuhet se Shqipëria ka rënë 27 vende në indeksin e perceptimit të korrupsionit të Transparency International. Nuk e thotë opozita, por Parlamenti Europian dhe Transparency International.

Në rezolutën e datës 19 maj shprehet shqetësimi për mbikëqyrjen dhe përgjegjshmërinë e dobësuar për prokurimin publik dhe shpenzimet e ndihmës së huaj gjatë pandemisë dhe kërkohet një korrigjim i shpejtë për mangësitë. Pra, diagnoza është shumë e qartë: një shpërdorim i qartë, flagrant, që shqetëson Parlamentin Europian. Sigurisht, nuk e shqetëson këtë krah të parlamentit, sepse ky krah është i destinuar vetëm të votojë. Mundësisht, maskat

që përdorëm gjatë pandemisë, mund t'i vendosin te sytë, jo te goja. Kjo është e vërteta. Për cilën të vërtetë flasin këta ministra, që ka një gëzim të madh nga partnerët tanë europianë, të cilët janë shumë të lumtur dhe për këto suksese do të na japin këto promovime të mëdha?

Ja, kjo është, këta i marrin vendimet. Do të ngrihet ndonjëri nga këta ta kundërshtojë, se ka nga këta që kanë edhe kurajë të marrë të thonë “nuk e lexove mirë”? Fjalë për fjalë po e lexoj. Parlamenti Europian është i shqetësuar, kurse këtu nuk janë të shqetësuar, janë të lumtur. Ai nënvizon rëndësinë e ndërmarrjes së veprimeve vendimtare, se ka vajtur atje ku nuk mban më, kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për të siguruar një histori të qëndrueshme të hetimeve proaktive, ndjekjes penale dhe dënimeve përfundimtare për korrupsion të nivelit të lartë. Kaq i madh është shqetësimi në Europë, rezolutë për të cilën votojnë të gjitha grupet, të majtë dhe të djathtë.

Madje, meqë jemi në planin e të gjitha marifeteve për të futur të gjitha paratë e qelbura në bankat shqiptare, jep edhe një përgjigje për një nismë tjetër, përveç nismës së famshme të amnistisë fiskale. Inkurajon Shqipërinë të përmbahet nga krijimi i një skeme shtetësi për investim, e cila mund të përbëjë rrezik serioz për sigurinë, pastrimin e parave, korrupsionin dhe evazionin fiskal. Janë të njëjtët europianë, të cilët shprehin të njëjtin preokupacion për pastrimin e parave, duke vazhduar të na mbajnë në listën gri, dhe unë nuk e kuptoj këtë kurajë, deri në kufijtë e debilitetit politik, që të vazhdosh të flasësh për suksese, kur treguesit janë kaq kokëfortë, kaq të qartë dhe kaq negativë, si kurrë më parë. Sigurisht, ka një objektiv, nga vendi i dytë në botë për korrupsion, pas diskutimit, me këtë ritëm mund të vijmë të proklamojmë dhe të duartrokasin të gjithë dhe të thonë: “Arritëm të jemi vendi i parë në botë”.

Në rast se kanë këtë objektiv, të na e thonë, por drejt atij po shkojnë, jo drejt një objektiv tjetër. Për sa i përket pikës së rendit të ditës, ndonëse vetë nuk flasin për temën e ditës, nga raporti vërej se janë pranuar 327 ankesa për prokurime që janë bërë në kurriz të ligjit, por nga këto ankesa janë marrë masa ndëshkimi me gjobë vetëm për 3 titullarë, pra, vetëm për 1%. Çfarë efience është kjo? Nuk kanë rëndësi qindra procedura të bëra në kundërshtim me ligjin? Kaq është masa e ndëshkueshmërisë? Pse duhet Komisioni i Prokurimit Publik në një vend ku 1

në 3 procedura apo edhe më shumë nuk zhvillohen me garë të hapur, por me lloj-lloj procedurash të tjera?

E njëjta histori ka ndodhur edhe me tenderët e rindërtimit, ku paratë publike janë shtruar në një qerasje të madhe klientësh gjithfarësh, të cilët nëpërmjet procedurave të tenderimit kanë pasur një mekanizëm të artë edhe për të bërë pastrim parash. Ndërkohë, për faktet publike, këto të qartat, të dala sheshit, pra për qindra procedura ankimesh, të pranuar dhe të shqyrtuara, vetëm tre janë përgjegjësit. Tre përgjegjës kanë bërë 300 procedura? Po për qindra procedura prokurimi të hapura në kushedi sa bashki të vendit pa pasur fonde në dispozicion dhe të denoncuar publikisht, me fakte jo me fjalë, ku është qëndrimi? Apo nuk ka gjë se pandëshkueshmëria do të vazhdojë të mbretërojë? Atij që thotë se pandëshkueshmëria ka mbaruar, duhet t'i vijë turp nga vetja, se pandëshkueshmëria mbretëron këtu.

Nëse pandëshkueshmëria nuk do të mbretëronte, Parlamenti Europian nuk do të thoshte e keni korrupsionin këmbëkryq dhe jeni vendi i dytë në botë për korrupsion. Kur ka ndëshkueshmëri të lartë, nuk je vendi i dytë në botë, por vend që po çlirohesh. Pse ka pandëshkueshmëri, vazhdon të jesh vendi më i korruptuar i Europës dhe nuk e dimë cili është ai vend në Afrikë me të cilin mund të krahasohemi. Këto janë të vërtetat e mëdha, për të cilat analiza sot, ashtu si analizat e shumë institucioneve të pavarura, është kthyer në një analizë formale, pasi gjysma këtej e parlamentit e ka braktisur përfundimisht funksionin e kontrollit të përgjegjshëm parlamentar mbi këto institucione, sepse pavarësia e tyre është nën mbikëqyrjen e parlamentit.

Parlamenti thjesht është shqetësuar të vendosë të preferuarit e zemrës të drejtojnë këto institucione dhe t'u sigurojë aty qetësinë, që ata të mos ndëshkojnë, të mos bëjnë asgjë dhe kjo ortakëri e mbajtjes së njëri-tjetrit të vazhdojë të mbretërojë. Faleminderit!